

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca plenare**

Seanca nr. 02-07/05

Prishtinë, më 19 dhe 20 maj 2005

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse e ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 94 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

**Kryesia** ia kishte propozuar Kuvendit këtë

**REND TË DITËS:**

1. Miratimi i Procesverbali të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës për reformimin e pushtetit lokal;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve;
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për Odën Ekonomike;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit “për procedurat kontestimore” ;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit “për mbeturinat”;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit “për lirinë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë”;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit “për borxhet”;
9. Shqyrtimi i propozim- Rregullores së punës të Kuvendit;
10. Shqyrtimi i propozimit të grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

## 1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

## 2. Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës për reformimin e pushtetit lokal

Kryeministri i Kosovës, **Bajram Kosumi**, e paraqiti fjalën hyrëse lidhur me Programin e Qeverisë së Kosovës për reformimin e pushtetit lokal.

Ministri i Pushtetit Lokal, **Lutfi Haziri**, e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit Programin e Qeverisë së Kosovës për reformimin e pushtetit lokal, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Programin e Qeverisë së Kosovës për reformimin e pushtetit lokal dhanë edhe këta deputetë: **Alush Gashi, Jakup Krasniqi, Gjylnaze Sylja, Veton Surroi, Mahir Jakxjillar, Emrush Xhemajli, Gjergj Dedaj, Ferid Agani, Numan Baliq, Sabit Rrahmani, Sabri Hamiti, Bajram Rexhepi, Hashim Thaçi, Fatmir Sejdiu, Hydajet Hyseni, Lulzim Zeneli, Zylfije Hundozi, Teutë Sahatxhia, Xhezair Murati, Ramadan Kelmendi, Nekibe Kelmendi, Enver Hoxhaj, Ramë Buja, Zylfi Zharku, Fetah Berisha, Gazmend Muhaxheri, Emin Krasniqi, Bislum Hoti, Sanije Alaj, Ylber Hysa, Rifat Krasniq, Sokol Bashota, Fehmi Mujota, Bajrush Xhemajli, Fatmire Mulhaxha, Nait Hasani, Berat Luzha, Sevdije Halimi, Genc Gorani, Xhevat Bislumi, Safete Hadërgjonaj, Nazim Jashari, Xhavit Haliti, Hajredin Hyseni, Nekibe Kelmendi, Naim Maloku, Hajredin Kuçi, Jonuz Kastrati, Sadudin Berisha, Qibrije Hoxha, Shaban Halimi, Ymer Halimi, Gani Koci, Mazllun Kumnova, Behxhet Brajshori, Milazim Haliti, Remzije Nimani dhe Fadil Geci, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi nxori këtë

### **Përfundim:**

1. Autorizohet Qeveria e Kosovës ta bëjnë vlerësimin dhe inkorporimin e vërejtjeve dhe të propozimeve nga debati dhe tekstin përfundimtar të Programit të saj për reformimin e pushtetit lokal t'ia paraqesë Kuvendit, në një afat të arsyeshëm.

## 3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Funkcional.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetik, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----97;  
Kundër----- 0;  
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, njëzëri e **miratoi** Ligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

#### **4. Shqyrtimi i raportit Të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për Odën Ekonomike**

**Kryetari** i informoi deputetët lidhur me procedurat e miratimit të Ligji për Odën Ekonomike të Kosovës–nr.2004/07, me vërejtjet e UNMIK-ut për atë ligj, si dhe me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Kuvendi njëzëri i miratoi amendamentet 1, 2, 3 dhe 4, të propozuara nga Komisioni për Ekonomi, Tregti dhe Industri në Ligjin për Odën Ekonomike të Kosovës..

#### **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbeturinat**

**Kryetari** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

**Zëvendësministri Merxhan Abdyli**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, zëvendësministri Abdyli i shpjegoi çështjet që i rregullon ky projektligj, si dhe strukturën e tij.

Me këtë projektligj definoohen dhe përcaktohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë për administrimin e mbeturinave.

Projektligjit i është bashkangjitur një shtojcë e veçantë, e cila është marrë nga Direktiva e Unionit Evropian, që e rregullon këtë fushë dhe duhet të miratohet bashkë me projektligjin.

Në fund, zëvendësministri Abdyli i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Besa Gaxheri, Berat Luzha, Mazllun Kumnova, Gazmend Muhaxheri, Ragip Zekolli dhe Fehmi Mujota**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 97;  
Kundër----- 0;  
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për mbeturinat. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

## 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për borxhet

**Kryetari** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

**Ministri Haki Shatri**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri Shatri i shpjegoi çështjet që i rregullon ky projektligj, si dhe strukturën e tij.

Projektligji përbëhet nga 7 pjesë – me 36 nene.

Pjesa e parë, rregullon fushëveprimin dhe përkufizimet, përkatësisht lëndën dhe qëllimin e ligjit.

Pjesa e dytë, përfshin dispozitat lidhur me ngarkimin e sektorit publik, format e hyrjes në borxh dhe niveli i ngarkimit.

Pjesa e tretë, përfshin dispozitat mbi administrimin me borxhin publik, me qëllim të menaxhimit efikas të tij.

Pjesa e katërt, përfshin dispozitat lidhur me lëshimin e garancioneve nga ana e Qeverisë së Kosovës, procedurën për paraqitjen e kërkesës për lëshimin e garancioneve qeveritare dhe përfundimin e garancionit.

Pjesa e pestë, dispozitat për letrat me vlerë, me të cilat rregullohen emetimi, llojet e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria, vlera, kushtet, mënyra e shitjes dhe afatet e tyre.

Pjesa e gjashtë, dispozitat që i referohen procedurave në raste të onlending-ut – formë e huas ku Qeveria merr mjete nga huadhënësi dhe ua jep shfrytëzuesve të fundit. Dhe pjesa e shtatë – përfshin dispozitat kalimtare.

Kryetari hapi diskutimin lidhur me këtë projektligj.

**Naser Osmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se materien që synon ta normojë Projektligji për borxhe është rregulluar me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Nuk ka nevojë të krijohet kolizion juridik ndërmjet tyre. Ky projektligj duhet të tërhiqet nga procedura e mëtejme e shqyrtimit.

**Stafete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, i bëri disa vërejtje përmbajtësore këtij projektligji.  
Ajo propozoi që ky projektligj t'i kthehet sponsoruesit.

**Mazllun Kumnova**, , në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, i bëri disa vërejtje këtij projektligji, të cilat duhen të përmirësohen gjatë fazave të shqyrtimit.

**Nazim Jaashari**, , në emër të Grupit Parlamentar ORA, tha se i përkrah parafolësit e tij që ky projektligj t'i kthehet sponsoruesit.

Pas këtyre diskutimeve Kuvendi nxori këtë

## **P Ë R F U N D I M**

1. Kuvendi i Kosovës nuk e miratoi Projektligjin për borxhet.
2. Projektligji për borxhet i kthehet Qeverisë së Kosovës, për veprim të mëtejshëm.

### **7. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare**

**Kuvendi**, pas shqyrtimit të propozimit të Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e tre (3) anëtarëve në komisionet parlamentare, mori këtë

## **V E N D I M**

1. Në Komisionin për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, në vend të z. Fatmir Sejdiu emërohet z. Sadudin Berisha.
2. Në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në vend të z. Sabri Hamiti emërohet znj. Remzije Nimani.
3. Në Komisionin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim në UE, në vend të z. Naim Jerliu emërohet z. Ilmi Ahmeti.

### **8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurat kontestimore**

**Kryetari** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

**Kryeministri Bajram Kosumi**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Projektligji përmban gjithsej 33 krerë dhe ka 530 nene.

Duke filluar nga dispozitat themelore deri në dispozitat kalimtare dhe të fundit. Tërë përmbajtja e Projektligjit paraqet një version të detajizuar të procedurave, të cilat janë zbatuar deri më tash nga gjykatat tona në çështjet kontestimore.

Me këtë projektligj janë ofruar zgjidhje sa i përket shumë vështirësive, me të cilat praktika gjyqësore është përballur gjatë zbatimit të ligjit të vjetër për procedurën kontestimore.

Me këtë Projektligj janë shkurtuar afatet, që kanë ekzistuar në ligjin e vjetër, dhe në disa raste nuk parashihen gjyqtarët porot.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nekibe Kelmendi, Nerxhivane Dauti, Bislim Hoti, Teutë Sahatçia, Ramadan Kelmendi dhe Milazim Haliti**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 58;

Kundër----- 1;

Abstenime-----26.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash **miratoi në parim** Projektligjin për procedurat kontestimore. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

## **9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për liritë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë**

**Kryetari** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

**Kryeministri Bajram Kosumi**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Projektligji përbëhet prej 4 kapitujve dhe 41 neneve, i cili ka strukturën si në vijim:

Me dispozitat e përgjithshme – kreu i parë, përcaktohet rregullimi i lirisë së besimit dhe statusi juridik i bashkësive fetare.

Me dispozitat e posaçme – kreu i dytë dhe tretë, rregullohet kryerja e ceremonive fetare, mundësia e themelimit të shkollave e fakulteteve të secilit nivel, paprekshmëria e hapësirave të bashkësive fetare, evidentimi i bashkësive fetare e tjera.

Me dispozitat përfundimtare – kreu i katërtë, rregullohet hyrja në fuqi e këtij ligji.

Qeveri e Kosovës konsideron se aprovimi i këtij projektligji përbën një hap shumë të rëndësishëm në drejtim të funksionalizimit të sistemit legjislativ në Kosovë dhe ju ftoj ta aprovoni këtë projektligj

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Sabri Hamiti, Berat Luzha, Gjylnaze Sylja, Genc Gorani, Xhezair Murati, Ferid Agani, Mark Krasniqi, Emrush Xhemajli, Naxhije Doçi, Gjergj Dedaj, Ibush Jonuzi, Ramdan Kelmendi dhe Ragip Zekolli**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 74;  
Kundër----- 0;  
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për liritë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Gjyqësi, Legjislacion dhe kornizë Kushtetuese – Komision raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

### **10. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për hartimin e Rregullores së punës të Kuvendit**

**Hajredin Kuçi**, në emër të Komisionit për hartimin e Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës, paraqiti raportin e punës së këtij komisioni.

Për propozim - Rregulloren e punës së Kuvendit diskutuan edhe këta deputetë: **Alush Gashi, Gjylnaze Syla, Nazim Jashari, Mahir Jakxhillar, Gjergj Dedaj, Sabri Hamiti, Berat Luzha, Fatmire Mulhaxha, Zef Morina, Nait Hasani dhe Hydajet Hyseni**, që i janë bashkangjitur transkriptim.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë propozim – Rregulloren e punës së Kuvendit. Rezultati ishte si vijon:

Për -----89;  
Kundër----- 3;  
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

## **V E N D I M**

1. Miratohet Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës.
2. Autorizohet Komisioni për Rregullore që të bënë standardizimin gjuhësor dhe juridik të Rregullores së Punës dhe të njëjtën ta boton si broshurë, për të gjithë deputetët.

**Kryetari** e deklaroi seancën të mbyllur në orën 15:15 minuta.

Përgatiti

**Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
Akademik **Nexhat DACI**